



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
**Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva**

## **PLANI I PUNËS SË KRYETARIT PËR VITIN 2024**

### **KOMUNA E PODUJEVËS**

**Shpejtim Bulliqi**  
**Kryetar i Komunës**

## Fjala betuese e kryetarit:

Besimi që kemi marrë nga ana e qytetarëve është nder, privilegj dhe përgjegjësi e madhe, që unë besoj që ne si përfaqësues të qytetarëve do t'i mbrojmë interesat e tyre dhe interesat e Komunës me përgjegjësi e përkushtim maksimal.

Jam jashtëzakonisht i nderuar dhe po aq përgjegjës që me bindje të lirë e me vullnet të qartë, qytetarët e Podujevës ma kanë deleguar detyrën e drejtimit të Ekzekutivit të Komunës tonë, një Komunë me një traditë e identitet të fuqishëm kombëtar e kolektiv të dëshmuar në çdo rrethanë.

E kam thënë edhe një vit më parë kur e fitova mandatin e parë, e do ta them çdo herë në çfarëdo cilësie se, kur e ka dashur puna e sakrificës për lirinë, të drejtat dhe mëvetësinë e tij, Llapi i ka dhënë Kosovës emra si Adem Demaçi, Shaban Shala dhe shumë të tjerë, kur e ka dashur puna që aspiratat tona kombëtare të merrnin formën e pa kompromis të rezistencës ndaj pushtimit, Llapi i ka dhënë Kosovës emra si Zahir Pajaziti, Afrim Zhitia, Ali Ajeti dhe të tjerë, kur e kërkonte puna që aspiratat tona kombëtare dhe artikulimi i projektit politik për liri, pavarësi dhe vetëvendosje të pikëtakoheshin me parimet universale politike, filozofike e morale të botës së qytetëruar, Llapi i jep Kosovës emra si Enver Maloku, Xhemajl Mustafa dhe të tjerë. Kur më së shumti kishte nevojë që Kosova të dëshmonte vitalitetin, energjinë dhe përkushtimin kolektiv për vlera kulturore e artistike, Llapi i jepte Kosovës emra si Avdush Hasani, Ismet Bogujevci, Maliq Musa dhe artistë të tjerë të mëdhenj. Kur e njëjta ndihej në sportet kolektive ne i kemi dhënë vendit sportistë si legjendat, Fadil Vokrri, Favzi Rama dhe të tjerë.

Të nderuar, sot edhe njëherë dua t'i përsëris disa nga parimet e udhëheqjes që i kemi ne, unë sot zotohem para Llapjanëve që zyra e Kryetarit të Komunës do të udhëhiqet nga parimi i gjithëpërfshirjes dhe trajtimit të barabartë sipas ligjit, shërbimi për qytetarët dhe ndaj qytetarëve do të jetë detyrë e jona e përditshme.

Nga këtu ju bëj thirrje qytetarëve, të rinjve dhe kuadrove të shumta që ka Llapi, të cilët kanë vullnetin, gatishmërinë dhe idealin për të kontribuar me ide apo çfarëdo lloj ndihme për Komunën e tyre, të na drejtohen, të na bashkohen dhe të na ndihmojnë.

Komuna e Podujevës do t'i mirëpresë, dëgjojë e sigurojë bashkëpunim e bashkëveprim konkret me të gjithë, pa asnjë dallim apo diskriminim. Komuna është shtëpia jonë e përbashkët, andaj ju inkurajoj të gjithëve të bëhemi bashkë, të punojmë shumë për ta forcuar dhe zhvilluar edhe më shumë.

Ju faleminderit, na priftë e mbara!

## *Zyrat në kuadër të Zyrës së Kryetarit të Komunës:*

- *Zyra e Personelit*
- *Zyra për Komunikim me Publikun dhe Informim*
- *Zyra e Auditorit të Brendshëm*
- *Zyra për integritet Evropian*
- *Zyra Ligjore*
- *Zyra e Prokurimit Publik*
- *Spektori për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete*

## *Drejtoria komunale:*

- Drejtoria e Administratës
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa
- Drejtoria e Arsimit
- Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
- Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit
- Drejtoria e Pronës dhe Kadstrit
- Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
- Drejtoria e Shërbimeve Publike
- Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik
- Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
- Drejtoria e Inspeksionit

# Prioritetet e qeverisjes 4-vjeçare:

## *ARSIMI*

- Digjitalizimi i shkollave:
  - Të gjitha klasat do jenë të pajisura me projektorë
  - Internet në çdo shkollë
  - Ditari elektronik
  - Kabinetet e informatikës në çdo shkollë
- Krijimi i hapësirave të reja shkollore:
  - Ndërtimi i një objekti të ri për shkollë fillore në qytet
  - Ndërtimi i një objekti të ri për shkollë të mesme profesionale
  - Ndërtim i shkollës në fshatin Obranqë
  - Ndërtimi i shkollës në fshatin Dumosh
  - Ndërtimi i shkollës në fshatin Lluga
- Ndërtimi i dy sallave të edukatës fizike
- Gjithëpërfshirja e fëmijëve në arsimin fillor dhe të mesëm
- Punë praktike për nxënësit e shkollave profesionale
- Shujta për nxënësit e klasave 1-5
- Rritja e buxhetit për bursa në 100 mijë euro
- Psikolog për çdo shkollë
- Rritje të përfshirjes së fëmijëve në edukimin e hershëm. Për këtë do të ketë rritje të klasave parafillore dhe do të hapen katër çerdhe të reja.

## ***URBANIZMI DHE INFRASTRUKTURA***

- Qyteti do ndërtohet në bazë të planit urbanistik të aprovuar , ky plan do ta bëjë Podujevën qytet të zhvilluar, me ndërtime moderne, infrastrukturë të zhvilluar, gjelbërim etj.
- Ambient i pastër dhe i gjelber. Brenda mandatit do të mbillen 20 mijë drunj
- Ndërtimi i rrugës “ Skënderbeu” dhe “ Xhemail Mustafa”
- Furnizimi me ujë të pijshëm për çdo fshat dhe lagje të qytetit
- Ndërtimi i rrugës përgjatë lumit Llap deri te magjistranja Podujevë-Prishtinë
- Plani i mobilitetit
- Ndërtimi i unazës së qytetit
- Asfaltimi i të gjitha rrugëve në fshatra
- Rregullimi i hapësirave publike në brezin e lumit Llap
- Ndërtimi i shtigjeve të bicikletave
- Ndërtimi i stacionit të autobusëve
- Ndërtimi i parkingut nëntokësor
- Rregullimi i parkut të paqes
- Ndriçim publik në çdo lagje të qytetit dhe fshat

## ***SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE***

- Ndërtimi i urgjencës së qytetit në periferi të qytetit
- Digjitalizimi i qendrave të mjekësisë familjare
- Qendrat e Mjekësisë Familjare do furnizohen me gjithë barnat e nevojshme dhe materialet e tjera për funksionimin normal të tyre
- Kontrollë sistematike për nxënësit, me qëllim parandalimin e sëmundjeve
- Zhvillimi i shërbimit paliativ shëndetësor
- Funkcionalizimi i hemodializës në qytetin e Podujevës
- Dyfishim i fondeve për mbështetje financiare për pacientët me sëmundje kronike
- Ndërtimi i qendrës për qëndrim ditë për persona të moshuar

## ***BUJQËSIA***

- 2 milionë euro subvencione nga buxheti komunal për bujqit në sektoret si :

Blegtoria

Pemtaria

Bletaria

Perimtaria

Prodhimtaria bimore

- Mekanizëm bujqësor
- Ndërtimi i sistemit të ujitjes së tokave bujqësore në luginën e Lumit Llap
- Tregu Online për bujqit
- Pyllëzimi i sipërfaqeve pyjore

## ***EKONOMIA***

- Zona Industriale me 37.2 hektarë
- Fond për mbështetje të prodhueseve vendorë. Do te krijohet një fond që do subvencionojë shpenzimet e interesit për kreditë investive në zgjerimin e kapaciteteve prodhuese.
- Inkubatori i bizneseve
- Themelimi dhe funksionalizimi ndërmarrjes publike me shërbime të integruara.
- Grante per themelimin e bizneseve nga te rinjtë dhe gratë
- Investime në turizmin malor

## ***KULTURA DHE SPORTI***

- Ndërtimi i shtëpisë së kulturës
- Funksionalizimi i galerisë dhe atelesë per artistë
- Pasurimi me libra i bibliotekës së qytetit
- Arti në hapësira publike
- Funksionalizimi i kinemasë së qytetit
- Krijimi i muzeut të qytetit
- Subvencionimi i aktiviteteve kulturore
- Ruajtja e objekteve të trashëgimisë kulturore
- Ndërtimi i palestrës së qytetit
- Ndërtimi i terreneve sportive në lagje të qytetit dhe fshatra
- Subvencionimi i klubeve sportive
- Funksionalizimi i sportit në shkolla dhe lidhja me klubet sportive në identifikimin e talenteve

## PROJEKTET PRIORITARE TË QEVERISJES GJATË 2024:

### Urbanizëm:

Nr.	Emërtimi i projektit	Totali	
	Buxheti Total	€	<b>3,000,806.12</b>
1	Ndërtimi i rrugës lidhëse nga magjistranja Podujevë-Prishtinë deri në rrugën " Vëllëzrit Frashëri" si dhe rrugën " Shaban Shala" me "28 Nëntorin"	€	500,000.00
2	Zgjerimi, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës "Xhemail Mustafa" me infrastrukturë përcjellëse	€	400,000.00
3	Rregullimi i hapësirave publike përgjatë Lumit Llap në qytet	€	300,000.00
4	Asfaltimi i rrugëve në qytet nga rruga " Zahir Pajaziti" deri te rruga "Skenderbeu"	€	325,000.00
5	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Orllan me rrethinë	€	100,833.00
6	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Balloc	€	81,040.00
7	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Bellopojë	€	90,000.00
8	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Lupç	€	75,153.12
9	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Letanc	€	70,450.00
10	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Gërdoc	€	50,500.00
11	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Dumnicë	€	80,400.00
12	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Repë	€	44,620.00
13	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Bradash	€	52,500.00
14	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Llaushë	€	61,000.00
15	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Doberdol	€	45,500.00
16	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Bajqinë	€	56,300.00
17	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Siboc	€	62,860.00



<b>18</b>	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Revuq	€	48,700.00
<b>19</b>	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Zakut	€	45,200.00
<b>20</b>	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Obrancë	€	43,800.00
<b>21</b>	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Tërrnavicë	€	52,000.00
<b>22</b>	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Sfeqel	€	43,800.00
<b>23</b>	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Shtedim	€	32,800.00
<b>24</b>	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Sallabajë	€	23,600.00
<b>25</b>	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Katunisht	€	30,530.00
<b>26</b>	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Shakovicë	€	24,000.00
<b>27</b>	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Surkish	€	33,660.00
<b>28</b>	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Gllamnik	€	30,500.00
<b>29</b>	Asfaltimi I rrugëve në fshatin Livadicë	€	29,300.00
<b>30</b>	Asfaltimi I rrugëve në fshatin Penuhë	€	38,220.00
<b>31</b>	Asfaltimi i rrugëve me Konushec	€	22,560.00
<b>32</b>	Asfaltimi i rrugëve në Lluzhan	€	31,840.00
<b>33</b>	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Shajkoc	€	25,520.00
<b>34</b>	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Lluga	€	21,400.00
<b>35</b>	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Kaçybeg	€	24,020.00

### *Infrastrukturë*

Nr.	Emërtimi i projektit	Totali	
	Buxheti Total	€	<b>2,526,870.00</b>
1	Ndërtimi i trotuareve nga rruga " Zahir Pajaziti" te rruga " Skenderbeu"	€	170,000.00
2	Zgjerimi dhe rregullimi i shtratit të lumit Llap në qytet	€	466,870.00
3	Shenjëzimet horizontale dhe vertikale	€	150,000.00
4	Ndriqimi publik ne fshatrat ( Dumnice, Gllamnik, Gerdoc, Bradash etj)	€	70,000.00
5	Kanalizimi nga fshati Lluzhan-Lupq dhe Gerdoc- Lluzhan dhe Majac-Lupç( Kolektori)	€	700,000.00
6	Meremetimi i rrugëve me zhavor	€	200,000.00
7	Ndërtimi i kalesave,urave të vogla ( Sfeqel. Pollatë, Gllamnik,Dumnicë, Kerpimeh etj)	€	70,000.00
8	Ndërtimi i rrugëve me elemente betoni ( ndërtimi i rrugëve me kubza betoni , ndërtimi i kalesave te vogela ne trotuare , ndërtimi i urave të vogla per kembesore etj) ne fshatra dhe qytet	€	250,000.00
9	Ndërtimi i mureve mbrojtëse	€	50,000.00
10	Rregullimi i infrastruktures se varrezave te qytetit	€	100,000.00
11	Riparimi i rrugëve të asfaltuara	€	300,000.00

### *Shëndetësi*

Nr.	Emërtimi i projektit	Totali	
	<b>Buxheti total</b>	€	<b>170,000.00</b>
1	Pajisje mjekësore	€	80,000.00
2	Renovimi i objekteve shëndetësore	€	90,000.00

### *Shërbime Rezidenciale*

Nr.	Emërtimi i projektit	Totali	
	<b>Buxheti total</b>	€	<b>28,000.00</b>

1	Ndërtimi i qendrës residenceale	€	50,000.00
2	Ndërtimi i shtëpise për personat me aftësi të kufizuar	€	230,000.00

### *Arsim*

Nr.	Emërtimi i projekteve	Totali	
<b>Buxheti Total</b>		<b>€</b>	<b>1,500,000.00</b>
1	Ndërtimi i një objekti të shkollës së Mesme te kampusi i shkollave të mesme	€	1,000,000.00
3	Permisimi i infrastruktures fizike shkollore	€	200,000.00
4	Ndërtimi i një objekti të ri të shkolles fillore në qytet	€	100,000.00
5	Ndërtimi i shkollës në fshatin Shajkoc	€	50,000.00
6	Renovimi i objektit të vjetër të shkolles në Kerpimëh dhe adaptimi për çerdhe	€	150,000.00

### *Zhvillim Ekonomik*

Nr.	Emërtimi i projekteve	Totali	
<b>Buxheti Total</b>		<b>€</b>	<b>808,554.38</b>
1	Ndërtimi i parkut industrial	€	658,554.38
2	Ngritja e infrastruktures së turizmit	€	100,000.00
3	Rregullimi i tregut të kafshëve	€	50,000.00

### *Kulturë, Rini dhe Sport*

	Emërtimi i projekteve	Totali	
<b>Buxheti Total</b>		<b>€</b>	<b>470,000.00</b>
1	Ndërtimi i terreneve sportive	€	200,000.00
2	Ndërtimi i shtëpisë së kulturës	€	100,000.00
3	Renovimi i objekteve të trashigimisë kulturore	€	70,000.00
4	Ndërtimi i shtatores së Ibrahim Rugovës	€	50,000.00
5	Ndërtimi i shtegut të vrapimit të parku i paqes	€	50,000.00

### *Subvencione:*

<b>SUBVENCIONE 2024</b>	<b>GQ</b>	<b>THV</b>	<b>TOTAL</b>
<b>SUBVENCIONE- BUJQËSI</b>	€ 686,336.00	€ 13,664.00	€ 700,000.00
Subvencione për perimkulturë	€ 236,336.00	€ 13,664.00	€ 250,000.00
Subvencione për bletari	€ 30,000.00		€ 30,000.00
Subvencione për blegtori	€ 270,000.00		€ 270,000.00
Subvencione me mekanizëm bujqësor	€ 100,000.00		€ 100,000.00
Subvencione për pentari	€ 50,000.00		€ 50,000.00
<b>SUBVENCIONE- KULTURË</b>	€ 30,757.00	€ 219,243.00	€ 250,000.00
Subvencione për teatër	€ 30,757.00	€ 19,243.00	€ 50,000.00
Subvencione për kulturë dhe sport		€ 200,000.00	€ 200,000.00
<b>SUBVENCIONE- ZHVILLIM EKONOMIK</b>		€ 300,000.00	€ 300,000.00
Subvencione per biznese dhe ndërmarrje publike		€ 300,000.00	€ 300,000.00
<b>SUBVENCIONE- ARSIM</b>	€ 89,243.00	€ 30,757.00	€ 120,000.00
Bursa për studentë	€ 89,243.00	€ 30,757.00	€ 120,000.00
<b>SUBVENCIONE- SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE</b>		€ 200,000.00	€ 200,000.00
Subvencione		€ 200,000.00	€ 200,000.00
<b>SUBVENCIONE- SHËRBIME PUBLIKE</b>		€ 100,000.00	€ 100,000.00
Subvencione per etnitete jo-publike		€ 100,000.00	€ 100,000.00
<b>TOTAL 2024</b>			€ 1,670,000.00

Ky plan i punës mund të ndryshojë gjatë vitit në bazë të dinamikës së punëve, mirëpo i përmban prioritetet dhe objektivat për vitin 2023.

Kryetari i Komunës së Podujevës

Shpejtim Bulliqi